



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 123, datë 20.10.2023

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “ADMINISTRIM BIZNESI”, TË KOLEGJIT UNIVERSITAR
“INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2023, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Administrim Biznesi”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “Administrim Biznesi”
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 10.11.2011
- d) Akreditimi i parë: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 137 datë 25.03.2016
- e) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Administrim Biznesit
- g) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra
- h) Kredite (ECTS): 180 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- j) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht
- k) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- l) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit të parë të këtij programi ka qënë pozitiv, pa rekomandime;
- f. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:

1. Kategoria formuese C, e kurrikulës së këtij programi studimi, nuk është plotësisht në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
2. Kualifikimet e disa prej titullarëve të lëndëve të angazhuar në këtë program studimi, nuk janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Mungesa e burimeve alternative të të ardhurave, përveç tarifave të studentëve dhe donacioneve të ortakëve, rrezikon qëndrueshmërinë e këtij programi studimi.
4. Mungesa e personelit ndihmës akademik lidhur me realizimin e praktikave mësimore dhe projekteve studimore e kërkimore, në funksion të këtij programi studimi.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,


VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Bachelor në **“Administrim Biznesi”**, të Kolegjit Universitar **“Instituti Kanadez i Teknologjisë”**.
2. Akreditimin e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite.

3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **19.10.2027**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shënim: Z. Maurice Oudejans dhe Znj. Lea Ypi, nuk morën pjesë në këtë mbledhje.

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 123, datë 20.10.2023, “Për akreditimin periodik të programit të studimit Bachelor në “**Administrim Biznesi**”, të Kolegjit Universitar “**Instituti Kanadez i Teknologjisë**”, janë si vijon:

1. Institucioni, të përshtasë kategorinë formuese C, të kurrikulës së këtij programi studimi, plotësisht në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
2. Institucioni, të marrë masa që, të gjithë titullarët e lëndëve të angazhuar në këtë program studimi, të jenë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Institucioni, të sigurojë burime alternative të të ardhurave, përveç tarifave të studentëve dhe donacioneve të ortakëve, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së këtij programi studimi.
4. Institucioni, të punësojë personel ndihmës akademik lidhur me realizimin e praktikave mësimore dhe projekteve studimore e kërkimore, për të mundësuar një përdorim sa më efektiv dhe eficient të kapitalit human në institucion, në funksion të këtij programi studimi.
5. Institucioni, të iniciojë mekanizma nxitës për personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, për të botuar artikuj shkencorë në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin e titujve akademikë.
6. Institucioni, të vërë në zbatim një mekanizëm antiplagjiaturë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale si në detyrat e kursit dhe punimet e tezës së diplomimit të studentëve të këtij programi studimi, apo në botimet e revistës institucionale CIT Review.
7. Institucioni, të shohë mundësinë e shtimit të personelit administrativ në zyrën e burimeve njerëzore, me qëllim përmbushjen më të mirë të funksioneve dhe përgjegjësi të kësaj zyre.
8. Institucioni, të marrë masa për zgjerimin e hapësirës së bibliotekës, si edhe përmirësimin e infrastrukturës kompjuterike duke rritur numrin e kompjuterave në përputhje me nevojat e studentëve të këtij programi studimi.
9. Institucioni, të parashikojë në aktet rregullatore të tij regjistrimin në këtë program studimi të studentëve të trojeve, studentëve me aftësi të kufizuara si edhe studentëve me status jetimi.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

